



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:126291

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06223233

C.nr.65/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. S. A. nga fshati..., Komuna e Dragashit të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokateve “K. &ASS. L.L.C” nga Prishtina, Rr. “Bl. D. e K.”, Ul. C-..., 2/.. hyrja 1., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, të cilën e përfaqëson i autorizuari Islam Rexheplari nga Dragashi, me bazë juridike kompensimin e shujtave ditore gjatë punës, vlera e kontestit 1,000.00 €, jashtë shqyrtimi, me dt. 27.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. S. A. nga fshati..., Komuna e Dragashit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Dragash, që paditëses A. S. A. nga fshati..., Komuna e Dragashit, në emër të kompensimit të shujtave gjatë punës për ditët e pranisë në punë për 126 ditë pune nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, duke llogaritur prej dates 01.06.2021 deri me datën 31.12.2021, **t’ia paguajë paditëses shumën e përgjithshme prej 252.00 € (dyqind e pesëdhjetë e dy euro)**, me kamat ligjore duke llogaritur në lartësi 8%, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja A. S. A. nga fshati..., Komuna e Dragashit, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi me 07.06.2022, kundër të paditurës Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, për kompensimin e shpenzimit të ushqimit gjatë ditës (shujtave ditore), të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 06.09.2024, **ku çështjen e ka paraqitur si në vijim:**

Paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (tutje: SHFMU) “2.. N.” në fshatin..., Komuna e Dragashit në pozitën e Mësueses klasore që nga viti shkollor 2017/2018 dhe vazhdon të punoj sot e kësaj dite në cilësinë e mësueses klasore. Tutje, ka theksuar se e paditura Komuna e Dragashit përkundër obligimeve dhe të drejtat të cilat

rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, konform dispozitave të nenit 35 pika 7 e kësaj marrëveshjeje, nuk ka bërë kompensimin e shujtave ditore dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, duke propozuar gjykatës aprovimin padisë dhe detyrimin e të paditurës që të bëjë pagesën e shpenzimeve të ushqimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar ka parashtruar përgjigjen në padi përmes parashtrësës të datës 09.09.2024 duke e kontestuar në tërësi padinë e paditësit, me arsyetimin se padia është e paqartë, pasi që e njëjta është e pa precizuar, pas datës 07.07.2021 e deri në fund të gushtit nuk ka pasur mësim përveç një ditë për provimet e nxënësve që kanë mbetur për muajin gusht. Prandaj duhet sqaruar edhe kjo çështje sepse sipas llogarisë tonë kanë mbetur edhe 4 muaj për kërkesën për ushqim të ngrohtë sipas padisë së re e që do të thotë maksimumi 85 ditë.

Gjykata duke parë mos kompleksitetin e lëndes dhe veçanërisht edhe praktikën gjyqësore të krijuar rreth këtyre lëndëve por gjithashtu edhe parimit të efikasiteti dhe ekonomizimit të procedurës paraparë me dispozita procedurale, përmes Aktvendimit të dt. 26.08.2024 i ka derguar paditëses padinë në plotësim dhe precizim, veprim të cilën përfaqësuesi i paditëses e ka bërë përmes parashtrësës së datës 06.09.2024.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhenjen e vendimit meritor, atëher ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jepë aktgjykimin me të cilën e pranon si të themelt kërkesëpadinë”*.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka lexuar kontratën të dt. 03.09.2019, Vërtetimin Nr.23/22 e dt. 28.01.2022, Diploma Nr.678 e datës 24.08.2017, lista e pagave në emër të paditëses.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se:

Kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar** nga arsyet e cekura si më poshtë:

Nga Listat e pagave në emër të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro.

Nga Kontratat e punës në emër të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura në kohë të pacaktuar dhe me kontratë I.

Nga Diploma Bachelor Nr.678 e dt.24.08.2017 në emër të A. F. S., gjykata vërtetoi faktin se paditësja me datë 12.07.2017, i ka përfunduar studimet në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” në Prizren, Fakulteti i Edukimit në Programin Fillor-Gjuhë Shqipe dhe ka marrë titullin “Bachelor i Programit Fillor”.

Nga administrimi i Vërtetimit mbi stazhin e punës lëshuar nga SHFMU “2.. N.” në fshatin..., Nr.23/22 e datës 28.01.2022, gjykata vërteton se paditësja A. S. A. nga data 01.06.2021 deri më 31.12.2021 ka punuar në këtë shkollë 126 ditë.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe neni 399.1 që përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura në cilësinë e mësimdhënëses (fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar të dt. 03.09.2019 dhe vërtetimi me nr. 23/22 dt.28.01.2022); nuk është kontestues fakti se e njëjta është me kualifikim shkollor fakultet (fakti vërtetuar nga diploma me nr.678 e dt. 24.08.2017); paga bazë e saj është 421.00 euro, si dhe fakti që e njëjta nga data 01.06.2021 e deri me datën 31.12.2021 ka gjithsejtë 126 ditë pune (fakt i vërtetuar në bazë të Vërtetimit Nr.23/2022 të dt. 28.01.2022).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, prova në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjithashtu sa i përket të drejtës për pagesë e shujtave, në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 (dhe asaj pasuese e datës 22.01.2021) me të cilën është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’u bërë kompensimin”*. Së këndejmi, rezulton se punëdhënës i paditësit është e paditura në këtë rast, Komuna e Dragashit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Ndërsa, sipas nenit 2 par. 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë shprehimisht precizohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*. Andaj, mbi bazën e kësaj që u paraqit, sipas raportit juridik të paditëses me të paditurën, këtë të fundit e bën plotësisht legjitime dhe me kompetencë për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, e as gjendjen faktike, por vetëm bazën e kërkesëpadiës, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadiës së paditëses e aprovuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se *“I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila*

përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dates 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”;

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017– 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Ndërsa sa i përket vlerësimit rreth shujtave gjykata ka vlerësuar se nga data 01.06.2021 – 31.12.2021 sa edhe ka qenë kërkesa e paditëses për ditet e pranisë në punë, për gjithsejt 126 ditë pune nga dy (2) euro për një ditë, t’i paguaj shumën prej 252 euro për shujta dhe si i tillë një vlerësim për gjykatën ka qenë i thjeshtë dhe për këtë arsye edhe nuk ka angazhuar ekspertizë përkatëse financiare duke synuar parasëgjithash ekonomizimin e procedurës.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, për përpilimin e padisë shumën 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 euro apo shumën totale prej 124,00 euro.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:126291, 27.09.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.